

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ka thënë se BDI-ja këtë herë ka arritur rezultate të mëdha, pasi ka fituar katër mandate më shumë se në zgjedhjet e kaluara.

“BDI-ja ka fituar katër mandate më shumë se në zgjedhjet e kaluara kundër oponentëve të partisë sonë. Fjala është për PDSH-në dhe RDK-në. Pra, kemi fituar 19 mandate dhe për më pak se 500 vota kemi mbetur pa fituar mandatin e 20. këtë herë fitorja e BDI-së është historike”, ka deklaruar Ahmeti në një intervistë për “Epokën e re”.

Ai ka bërë me dije se si forcë e parë politike shqiptare do të fillojnë konsultimet me partinë

fituese të zgjedhjeve për të qenë pjesë e qeverisë së re. Duke folur për mundësitë e një

koalicioni qeverisës ashtu siç e ka paralajmëruar para zgjedhjeve Menduh Thaçi në mes të

PDSH-së dhe VMRO-DPMNE-së, Ahmeti ka thënë se fituese e zgjedhjeve ndër shqiptarë është

BDI-ja.

“Fitues të zgjedhjeve ndër shqiptarë jemi ne dhe nuk mund të ndodhë një qeveri e tillë, sepse

me pastaj do të ketë destabilitet të Maqedonisë”, është shprehur Ahmeti, duke thënë se

prioritet i BDI-së do të jetë thellimi i bashkëpunimit për fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e

rajonit./Epoka e Re/